(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**Afatet e realizimit të punimeve: 3 muaj**

Grafiku i punimeve do të gjendet bashkëngjitur dokumentave të ngarkuara ne Sistemin e Prokurimit Elektronik

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **2,900,000 (dy milion e nëntëqind mijë) lekë.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar., ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk
duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|---|----------------|
| a. NP-1: Punime gjurmimi në tokë. | “Kategoria A”. |
| b. NP-2: Ndërtime civile dhe industriale | “Kategoria A”. |
| c. NP-3: Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. | “Kategoria A” |
| d. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve | “Kategoria A” |
| e. NS-2: Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre | “Kategoria A” |

- f. NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese **“Kategoria A”**
- g. N.S–14: Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. **“Kategoria A”**

Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

➤ **NP-1: Punime gërmimi në tokë** **“Kategoria A”**
Konsiderohen gërmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

➤ **NP-2: Ndërtimi civil dhe industriale** **“Kategoria A”**
Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

➤ **NP-3: Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.** **“Kategoria A”.**
Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje..

➤ **N.S. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve** **“Kategoria A”**
Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **NS-2: Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre.** **“Kategoria A”**
Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavaxerisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

➤ **NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.** **“Kategoria A”**
Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

➤ **NS-14: Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.** **“Kategoria A”**
Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhinier elektrik 1 (nje)
- c. Inxhinier hidroteknik 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim. Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier “.

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim. Ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** -per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- b. **Specialiste karpentiere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- c. **Specialiste pllakashtrues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- d. **Specialiste suvatues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- e. **Elektriciste 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e në vazhdim.
- f. **Hidraulike 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- g. **Hidroizolues 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.

- h. Bojaxhinje 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim.
- i. Shofere 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim, (Ne rastet kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar dhe si pasojë nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- j. Manovratore 3(tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim, (Ne rastet kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar dhe si pasojë nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike te objektit qe prokurohet, zbërthimin e projektit , për sistemin hidrik te rrjedhes se ujit ne tubacionet e furnizimit me uje dhe ne tuabcionet e ujrve te bardha dhe te zeza qe do te vendosen ne rruge si dhe lidhjen e tyre me rrjetin ekzistues apo te ardhshem.
- **Inxhinier elektrik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve elektrike te objektit qe prokurohet, zbërthimin e projektit , për sistemin eletrik dhe ne lidhjen e tij me rrjetin ekzistues apo te ardhshem.
- **Specialisti** (profili - karpentier, nivelues betoni, shtrues pllakash, suvatues etj) eshte pergjegjes (sipas profileve)
 - Per pergatitjen e armatures se derrases dhe betonimin e strukturave te ndryshme b/a, ne objektik qe prokurohet.
 - Per niveimin e strukturave beton, b/a , llace nivelimi etj ne objektin qe prokurohet.
 - Per shtrimin e pllakave te brendeshme dhe te jashtme ne objektin qe prokurohet.
 - Per suvatimin e siperfaqeve te mureve dhe soletes , te brendshme dhe te jashtme ne objektin qe prokurohet.
- **Elektracisti** eshte pergjegjes per pergatitjen dhe betonimin e shtresave dhe veshjave anesore me beton ose b/a ne objektik qe prokurohet.
- **Hidrauliku** eshte pergjegjes per pergatitjen dhe betonimin e shtresave dhe veshjave anesore me beton ose b/a ne objektik qe prokurohet.
- **Bojaxhiu** eshte pergjegjes per zbatimin e punimeve te veshjes me system kapot te godines dhe lysterjen me boje grafiato ne pjesen e jashtme dhe me boje hidropalstike ne pjesen e brendshem ne objektin qe prokurohet.

- **Hidroizolues** eshte personi pergjegjes per zbatimin e punimeve te hidroizolimit te objektit si ne pjeset e brendeshme ashtu edhe ne pjeset e jashtme te objektit qe prokurohet.
- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantier dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.
- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantier dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 19 (nëntëmbëdhjetë) persona**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shenim: Argumentimi mbi numrin e punonjesve.

Ne objektin **“Rikonstruksion dhe adaptim i kopshtit Verbas ne qender ambulatorore”** proceset e punes klasifikohen ne keto kategori:

a) Punime per mobilizimin e kantierit

Ne keto punime perfshihet pergatitja e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do t percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te stukturohet organika e njerezve qe do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i kantierit me hyrje-daljet e tij. Afati i parashikuar 6 dite pune. Puntore te angazhuar: 1 specialist dhe 2 puntore. Makineri Kamiocine dhe/ose pick-up.

b) Punime prishjeje

- **Volumi I punimeve** **26.6 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **383 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.07 m2/op**

Keto punime perfshijne punimet per prishjen e soletes se sobjetit, prishjen e mureve te tulles sipas percaktimit ne projekt dhe prishjen e te gjitha suvatimeve te brendeshme dhe t ejashtme. Ne kete kategori punimesh perfshihet edhe ngarkimi i te gjitha mbeturinave inerte dhe transporti i tyre per ne vendgrumbullimin e mbetjeve inerte. Për afat e kerkuar te punimeve prej 8 dite pune duhet qe kapaciteti teknik duhet të jetë 6 here me i larte kapacitetit nominal. Kërkesa per mjete pune 2 matrapik, 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 gjenerator, 1 depozite uji.. Gjithesej puntore te angazhuar: 2 specialiste dhe 4 puntore.

c) Punime murature

- **Volumi I punimeve** **16.55 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **248 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.066 m3/op**

Keto punime perfshijne ndertimin e mureve te reja sipas percaktimeve ne projekt. Orari nominal mesatar per punimet ne trupin e rruges eshte rreth 14.98 ore/m3. Referuar grafikut qe parashikon afatin 6 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 5 here me shume, ose 3specialiste dhe 2 puntore. Makinerite qe nevojiten jane: 1 betoniere, 1 vibrator betoni, 2 trako, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 pompe llaci, 1 gjenerator, 1 depozite uji.

d) Punime b/a

- **Volumi I punimeve** **96.38 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **949 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.102 m3/op**

Keto punime perfshijne ndertimin e soletes b/a , ndertrimin e brezave b/a, ndertimin e arkitrareve b/a. Orari nominal mesatar per punimet ne trupin e rruges eshte rreth 9.846 ore/m3. Referuar grafikut qe parashikon afatin 20 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 8 here me shume, ose 6specialiste dhe 2 puntore. Makinerite qe nevojiten jane: 1 betoniere, 1 vibrator betoni, 2 trako, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 pompe llaci, 1 gjenerator, 1 depozite uji, skela inventari 150 m2.

e) Punime hidroizolimi ne tarrace.

- **Volumi I punimeve** **55.4 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **206 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.269 m2/op**

Keto punime perfshijne punimet e termo dhe hidro – izolimit te taraces se godines. Orari mesatar per punimet e termo dhe hidro izolimit te traaces eshte rreth 3.718 ore/m2. Afati i parashikuar per perfundimin e punes 5 dp. Per realizimin e ketij volumi ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste + 2 puntore. Makineri dhe mjete ne dispozicion: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 gjenerator, 1 depozite uji, 1 kanello, 2 bombula gazi litra.

f) Punime shtresash e veshje.

- **Volumi I punimeve** **49.3 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **331 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.149 m2/op**

Keto punime perfshijne punimet e ndertimin e shtresave te objektit dhe punimet e veshjes se se tualetit. Orari mesatar per punimet e shtresave dhe te veshjes eshte rreth 6.714 ore/m2. Afati i parashikuar per perfundimin e punes 10 dp. Per realizimin e ketij volumi ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste + 2 puntore. Makineri dhe mjete ne dispozicion: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 gjenerator, 1 depozite uji, 1 makine prerese plakash qeramike dhe/ose gres porcelanato, 2 trapane per perzierjen e kolit.

g) Punime per suvatimi dhe lysterjen e brendshme.

- **Volumi I punimeve** **258 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **1341 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.192 m2/op**

Keto punime perfshijne suvatimin e te gjithë siperfaqes se brendeshme dhe te jashtme te objekti dhe lysterjen me bojra sipas percaktimeve ne projekt me boje hidroplastike. Orari mesatar I punimeve te suvatimit eshte 5.198 ore/m². Afati I perfundimit per punimet e suvatimit eshte 15 dite pune dhe nevojiten 4 specialiste dhe 2 puntore. Afati per perfundimin e punimeve te lysterjes se brendeshme eshte 5 dite pune dhe per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 1 puntore. Makineri dhe mjete ne dispozicion: 1 kamociene, 1 gjenerator, 1 depozite uji, 1 trapano, 1 trako.

h) Punime dyer e dritare

- **Volumi I punimeve** **13.2 m².**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **31.6 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.418 m²/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e dyer dritareve te gatshme te parapergatitura me te gjithë aksesoret e tyre. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 1 dite pune, orari mesatar i punimeve 2.39 ore/m². Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 1 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamociene, 1 gjenerator, 1 trapano, 1 trako.

i) Punime hidrosanitare

- **Volumi I punimeve** **4.0 m².**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **68 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.059 m²/op.**

Keto punime perfshijne prishjen e linjave te tualeteve ekzistuese dhe zevendesimin e te gjitha pajisjeve dhe linjave te ujit te ftohte dhe te ngrohte sipas percaktimeve ne projekt, perfshire lidhjen me linjat e rrjetit te furnizimit me uje dhe shakarkimit te ujrave te zeza te ketyre tualeteve ne gropen septike. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 3 dite pune, orari mesatar i punimeve 17 ore/m². Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 1 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamociene, 1 gjenerator, 1 depozite uji, 1 trapano, 1 trako.

j) Punime per gropen septike

- **Volumi I punimeve** **12 m³.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **480 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.025 m²/op.**

Keto punime perfshijne germimin evendit ku do te vendoset grupa septike, nenshtresat, shtresat dhe muret e gropes septike se bashku me soleten mbulimit te saj dhe lidhjen me linjat e shkarkimit te ujrave te zeza te tualetit. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 15 dite pune, orari mesatar i punimeve 40 ore/m³. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 1 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 skrep, 1 kamion veteshkarkues, 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamociene, 1 gjenerator, 1 depozite uji, 1 trapano, 1 trako.

k) Punime elektrike

- **Volumi I punimeve** **50 m²**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **144 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.347 m²/op.**

Keto punime perfshijne ndertimin e rrejtit te instalimeve te reaj elektrike sipas percaktimeve ne projekt. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 6 dite pune, orari mesatar i punimeve 2.88 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste elektriciste dhe 1 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamioncine, 1 gjenerator, 1 trapano, 1 trako.

l) Punime per sistemimin e jshtem

- **Volumi I punimeve** **65.4 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **233 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.281 m2/op.**

Keto punime perfshijne sistemimin e teritori te qendres ambulatorore, krijimin e siperfaqeve te gjelberuara dhe si[perfaqeve me pllaka betoni te parapergatitura dhe vendosja e stolave dhe gjelberimi. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 6 dite pune, orari mesatar i punimeve 38.6 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 2 matrapik, 2 karro dore, 1 kamioncine, 1 gjenerator, 1 depozite uji, prerese pllakash betoni, 1 trapano, 1 trako.

m) Punime per demobilizimin e kantierit

Per demobilizimin e kantierit duke qene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (minikantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- **Teknike ndertimi** **1(nje)**
- **Karpentier** **2 (dy).**
- **Pllakashtrues** **2 (dy)**
- **Suvatues** **2 (dy)**
- **Elektriciste** **1 (dy).**
- **Hidraulike** **1 (dy).**
- **Hidroizolues** **1 (dy)**
- **Bojaxhinj** **2 (dy).**
- **Shofere** **1 (dy).**
- **Manovratore** **3 (tre)**
- **Drejtues Teknik** **3 (tre)**

TOTALI = 19 (nentembedhjete) Persona ne Staf.

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialitetev ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion veteshkarkues me aftesi mbajtese mbi 20 ton cope** **2 (dy)**
- **Kamion veteshkarkues me aftesi mbajtese mbi 8 ton cope** **1 (nje)**

• Kamoci me aftesi mbajtese deri ne 3.5ton	cope	1 (nje)
• Skrep me goma	cope	1 (nje)
• Mini Fadrome	cope	1 (nje)
• Betoniere	cope	2 (dy)
• Depozite uji uji jo më pak se 1m3	cope	2 (dy)
• Pompe uji	cope	2 (dy)
• Vibrator betoni	cope	3 (tre)
• Matrapik	cope	3 (tre)
• Trapano elektrike	cope	2 (dy)
• Gjenerator uji jo më pak se 3.5KW	cope	1 (nje)
• Skela metalike	m2	150

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë object.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente** , Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar

nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik

_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

				• nfor maci on mbi
subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik				
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në</p>

nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari,

në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

